



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 4
04.01.2018

NR. VENDIMI 22
27.09.2018

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTAR: BIB NDRECA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Alma Stafaj**, sot më datë 27.09.2018, ora 10:05, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen me numër regjistri 4 që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Klodjan BRAHO**.

KUNDËR:

O. D., i biri i H. dhe i H., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx (xxxx) xxxx, përfaqësuar në gjykim nga **av.A. Gj.**, me licensë me nr.xxxx dhe Nipt xxxx, anëtar i Dhomës Avokatisë xxxx.

PERSONA TË TRETË:

1) H. D., i biri i S. dhe i I., dtl xxxx, lindur dhe banues në xxxx, me adresë: Lagjia “xxxx”, shtëpi private, pa numër, me gjendje civile i xxxx, përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur Av.L. M., me licensë me nr.xxxx dhe Nipt xxxx, anëtar i Dhomës Avokatisë xxxx, me adresë: Rruga “xxxx” pallati xxxx, kati x, zyra xxx.
2) A. D., i biri i H. dhe i H., dtl xxxx, lindur dhe banues në xxxx, me adresë: Lagjia “xxxx”, me gjendje civile xxxx, përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur Av.L. M., me licensë me nr.xxxx dhe Nipt xxxx, anëtar i Dhomës Avokatisë Tiranë, me

adresë: Rruga “xxxx” pallati xxxx, kati x, zyra xxx.

3) **N. D.**, i biri i H. dhe i H., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx, përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur Av.L. M., me licensë me nr.xxx dhe Nipt xxxx, anëtar i Dhomës Avokatisë xxxx, me adresë: Rruga “xxxx” pallati xxxx, kati x, zyra xxxx.

4) **Sh. D.**, e bija e H. dhe e H., dtl xxxx, lindur në xxxx, dhe banuese në xxxx, me gjendje civile xxxx, përfaqësuar në gjykim nga **av.A. Gj.**, me licensë me nr.xxxx dhe Nipt xxxx, anëtar i Dhomës Avokatisë xxxx, dhe avokate e caktuar kryesisht Av.E. B..

OBJEKTI:

I. Konfiskimin e sipërfaqes ndërtimore prej **xxxx m²** në objektin e ndërtuar me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr.x, datë xxxx, të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx, që përfaqëson xxx % të sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore të objektit të ndërtuar mbi pasurinë e rregjistruar në Z.V.Rr.P.P xxxx nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xxx, faqe xxx, ndodhur në xxxx, duke e kaluar atë në pronësi të shtetit.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurisë së paluajtshme të ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, administrator S. M..

III. Shpenzimet procedurjale tju ngarkohen shtetasit O. D. dhe personave të tretë, në mënyrë solidare.

BAZA LIGJORE:

Nenet 24 e vijues të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi dëgjoji palët ku:

Prokurori kërkoi : I. Konfiskimin e sipërfaqes ndërtimore prej **xxxx m²** në objektin e ndërtuar me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin

nr.xxx, datë xxxx të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx, që përfaqëson xxxx % të sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore të objektit të ndërtuar mbi pasurinë e rregjistruar në Z.V.Rr.P.P xxxx nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xxx, faqe xxx, ndodhur në xxxx, duke e kaluar atë në pronësi të shtetit.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurisë së paluajtshme të ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, administrator S. M..

III. Shpenzimet procedurjale tju ngarkohen shtetasit O. D. dhe personave të tretë, në mënyrë solidare.

Shtetasi O. D. dhe avokati A. Gj. kërkuan: në mbështetje të nenit 24/a të Ligjit 10192 datë 03.12.2009 “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar, të vendoset refuzimi i konfiskimit pasi palët justifikojnë me dokumenta financiare vlerën e investimit.

Përfaqësuesi i personave të tretë H. D., A. D., N. D., Av.L. M. kërkoi: Refuzimin e konfiskimit të sipërfaqes ndërtimore xxxx m², pasuria Nr.xxxx truall me sip xxx m², dhe objektin “Magazinë + Godinë Shërbimi” në fshatin xxxx të regjistruar në pronësi të paditurit O. D..

Përfaqësuesit e personit të tretë Sh. D., Av.A. Gj., dhe Av.E. B. kërkuan: për personin e tretë Sh. D., në mbështetje të nenit 24/a të Ligjit 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar, të vendoset refuzimi i konfiskimit pasi palët justifikojnë me dokumenta financiare vlerën e investimit.

O. D. ishte dakort me avokatin, vendimet për dënimin e tij nuk ishin të formës së prerë pasi ishin prishur në Gjykatat e Apelit, nuk ishte e vërtetë se pasuria ishte vënë në kohën kur i referohet prokurori. Gjykata, pasi shqyrtoi provat dhe analizoi në tërësi rrethanat e çështjes objekt gjykimi,

VËREN:

Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për konfiskim, kundër O. D. (kërkesë e rregjistruar në Gjykatë me datë xxxx), që të konfiskohej pasuria me objekt:

“ *Sipërfaqe ndërtimore prej **xxxx m²** në objektin e ndërtuar me lejen e*

ndërtimit të miratuar me vendimin nr.x, datë xxxx të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx, ndodhur mbi pasurinë e rregjistruar në Z.V.Rr.P.P xxxx nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xx, faqe xxx, ndodhur në xxxx, duke e kaluar atë në pronësi të shtetit, por që në konkluzione përfundimtare prokurori përfundimisht kërkoi Konfiskimin e sipërfaqes ndërtimore prej **xxxx m²**, që përfaqësonte xxx % të sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore.”

I. Legjitimimi i palëve.

Pas parashtrimit të kërkesës dhe provave nga prokurori (konformë nenit 356 të K.Pr.Penale), në momentin e parashtrimeve dhe paraqitjes së provave nga personi ndaj të cilit u kërkua konfiskimi i pasurisë (dhe avokati i tij), nga ana e kësaj pale dhe përfaqësuesit të tij, u pretendua se objekti për të cilin ishte kërkuar konfiskimi nuk ishte “investim” vetëm i tij, por edhe i familjarëve si babai, vëllezërit, si dhe kjo pronë ishte vënë gjatë kohës që ai ishte në martesë, dhe në këto kushte i kërkoi gjykatës që të thirreshin si persona të tretë shtetasit H. D., A. D., N. D. dhe Sh. D..

Në mbështetje të pretendimit të tij, kjo palë paraqiti ndër të tjera si prova shkresore kontratë Nr.xxx Rep, nr.xxxx Kol, datë xxxx, ku pasqyroheshin të drejtat dhe detyrimet lidhur me ndërtimin e një kapanoni x kat dhe zyra për administratën x kat duke treguar dhe “pjesmarrjen” në investim të personave të tretë. Ndërsa lidhur me faktin që gjatë kohës së vënies së pasurisë objekt konfiskimi O. D. kishe qenë në lidhje martesore me Sh. D., u paraqit çertifikatë martesë (dhe ajo familjare) ku pasqyrohet fakti juridik i martesës së tyre që me datë xxxx.

Gjykata, me vendim të ndërmjetëm, konformë nenit 22 pika 3 të ligjit nr.10192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar, thirri me cilësinë e personave të tretë në gjykim shtetasit H. D., A. D., N. D. dhe Sh. D., duke marrë masa për njoftimin e tyre, të cilët gjatë gjykimit u përfaqësuan me mbrojtësit respektivë të cituar sa më lartë.

Personat e tretë H. D., A. D., dhe Sh. D., u paraqitën personalisht duke zgjedhur mbrojtësit e tyre, duke dhënë tagër që gjykimi të vijonte pa praninë e tyre, ndërsa N. D. nuk u paraqit personalisht, por me prokurë i ka deleguar tagrat e përfaqësimit Av.L. M..

Megjithëse nga ana e Gjykatës, u ndërmorën masa për të bërë të mundur përfundimin e çështjes në një afat sa më të shkurtër, përshkak të mungesës së adresave të palëve, kompleksitetit të saj, pyetjes së

dëshmitarëve, dhe nevojës për të kryer ekspertime me ekspert më njohuri në fushën e shkencës dhe teknikës (Ekspertime vlerësuese dhe kontabël), gjykimi i kësaj çështje nuk përfundoi brenda afatit 3 mujor, por gjithësesi ai përfundoi brenda afatit të kondicionuar nga neni 23/2 i Ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009.

I. Lidhur me kompetencën lëndore dhe kompozimin në gjykimin e kësaj çështjeje.

Ligji 70/2017, ka ndryshuar ligjin Nr.10192, datë 3.12.2009. Ligji në fjalë ka parashikuar një sërë ndryshimesh ndër të tjera kompetencën lëndore, mënyrën e gjykimit, mbledhjen e provave deri tek natyra e gjykimit. Ndër të tjera në nenin 5 pika 2 e ligjit parashikohet se: *Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në **Kodin e Procedurës Penale**, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.* Në ndryshim nga sa parashikonte para ndryshimeve me ligjin 70/2017, ku në këto lloj gjykimesh zbatoheshin rregullat e gjykimit sipas këtij ligji dhe dispozitat e K.Pr.Civile.

Në nenin 7/1 të ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, parashikohet se: *Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.*

Duke qenë se akoma nuk është krijuar *Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar*, ajo që na vjen në ndihmë për përcaktimin e kompetencës është dispozita kalimtare ndryshuar me ligjin 70/2017. Kështu sipas dispozitës kalimtare: *...4.Deri në krijimin e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda. 5. Me krijimin e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar çështjet në gjykim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë gjykatë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.*

Gjithashtu sipas dispozitës kalimtare, ligji i ndryshuar zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij. Duke qenë se kërkesa është paraqitur në gjykatë me datë xxxx, gjykata çmon se duhet të zbatohen në rastin konkret dispozitat e këtij ligji.

Në interpretim sa më sipër, gjykata çmoi se është kompetente për nga pikëpamja lëndore dhe tokësore, për gjykimin e kësaj çështje (të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Lartë në Vendimin Njësues të datës

xxxx). Përsa i përket kompozimit të trupit Gjykues, në zbatim të nenit 7/4 të ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar kjo çështje duhet të gjykohet me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

I. Gjatë hetimit gjyqësor rezultuan rrethanat e mëposhtme.

Me datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin e kësaj date, ka regjistruar procedimi pasuror nr.xxxx, viti xxxx. Ky rregjistrim është bërë mbi bazën e materjaleve të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx.

Ndër të tjera në këtë vendim sqarohet se: Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit xxxx, ka bërë referimin lidhur me procedimin pasuror nr.xxx, të vitit xxxx, dhe e ka dërguar atë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë. Në vijim të verifikimeve pasurore, ka rezultuar se në kuadër të hetimeve paraprake të procedimit penal nr.xxxx viti xxxx të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, shtetasi O. D. është akuzuar se ka kryer veprën penale “*pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287/1, germa (d) e Kodit Penal.

Lidhur me faktin penal për veprën penale për të cilën është akuzuar O. D., ka rezultuar se në kohën kur ai kishte qenë me detyrën e Inspektorit të Kontrollit Tatimor pranë Degës së Tatimeve xxxx, (në periudhën xxxx-xxxx), ka krijuar njohje të disa Subjekteve tatimore në zonën e xxxx. Pas largimit nga detyra ai ka punuar si ekonomist i jashtëm për disa subjekte, ku duke shfrytëzuar besimin që kishin për të, ai ka tërhequr disa blloqe faturash tatimore. Më pas ai nëpërmjet falsifikimit të faturave TVSh-ve, duke përshkruar transaksione të pavërteta, në bashkëpunim me persona të tjerë, ka përfituar një shumë prej xxxx lekë. Këtë shumë më pas sipas akuzës ai e ka investuar në ndërtimin e një objekti “magazinë+godinë shërbimi”, të ndodhur në xxxx.

Nga ana e Prokurorisë xxxx është Urdhëruar Rregjistrimi i Procedimit Penal, Nr.xxxx, datë xxxx, që bën fjalë për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal, kjo mbi bazën e materjalit të dërguar nga Prokuroria xxxx. Kjo pasi ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit xxxx, ka dërguar për gjykim procedimin penal nr.xxxx të vitit xxxx, që bën fjalë për veprat penale të “Mashttrimit”, Fshehjes së të Ardhurave, dhe fallsifikimit të vulave, stampave, ose formularëve të parashikuar nga neni 143/2, 180, 190/2 të K.Penal.

Ndër të tjera sipas akuzës gjatë hetimit penale ka rezultuar se shtetasi O. D. gjatë viteve xxxx, ka qenë me detyrë inspektor i kontrollit tatimor pranë degës xxxx.

Gjatë vitit xxxx, ka kryer kontrolle tatimore në subjektin x.shpk, dhe pas largimit nga detyra xxxx, në cilësinë e ekonomistit të subjekteve xxxx, shpk, xxxx shpk, dhe xxxx.shpk, me seli në xxxx, ka tërhequr në emër të tyre x blloqe (me nga x fatuara seicila), fatura tatimore TVSh-je. Faturat e TVSh-së nuk rezultojnë të jenë plotësuar në emër të këtyre subjekteve si shitës, por në emër të disa subjekteve të tjerë duke pasqyruar të dhëna të rreme, si në formë dhe në përmbajtje me qëllim për të përfituar në mënyrë të paligjshme kreditimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Në lidhje me këtë fakt penal shtetasi O. D. është dërguar në gjyq për veprën penale të Fallsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda parashikuar nga neni 190/2 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, ka vendosur ndër të tjera “Deklarimin Fajtor të të pandehurit O. D. për veprën penale të “Fallsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, më shumë se një herë, dhe në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 190/2 të K.Penale, dënimin e tij me x vite burg.

Kështu referuar akteve të dosjes, O. D. nëpërmjet falsifikimit të faturave tvsh-je dhe nëpërmjet përshkrimit të transaksioneve të pavërteta, në bashkëpunim me persona të tjerë, ka përfituar një shumë prej xxxx lekë.

Me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, ka vendosur vënien e sekuestros për objektin Magazinë, + Godinë shërbimi në xxxx (Investim dhe leje ndërtimi në emër të O. D.). Prokuroria e rrethit Gjyqësor xxxx, ndër të tjera ka urdhëruar kqyrjen e sendit, send i cili rezultojnë që është kqyruar sipas procesverbalit të datës xxxx, (lidhur me vendodhjen, kufizimet, përmasat etj) e shoqëruar me tabelë fotografike.

Gjithashtu Prokuroria xxxx me vendimin e datës xxxx, ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit vlerësues të objektit magazinë +godinë shërbimi me vendodhje xxxx.

Ekspertet S. A. dhe D. Sh., kanë kryer aktin e ekspertimit vlerësues (duke nxierrë vlerat përkatëse, të cilat u pyeten gjatë gjykimit edhe si dëshmitare, ku duke qenë se akti kishte gabime në shifra ato i korigjuan, për të cilat do të vijohet më poshtë në këtë vendim).

Me vendimin e datës xxxx, nga Prokuroria e Rrethit xxxx, O. D. i është komunikuar akuza, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal (dhe më pas duke dërguar çështjen për gjykim).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, (gjykim i zhvilluar në mungesë të të pandehurit O.

D.), ka vendosur ndër të tjera: Deklarimin fajtor të të pandehurit O. D., për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal, duke e dënuar me x vite burgim. Konfiskimin e objektit të sekuestruar me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, për vlerën xxxx lekë.

Në vendimin në fjalë pasqyrohen veprimet konkrete që ka kryer O. D.. Gjatë hetimit Gjyqësor kanë rezultuar se xxx fatura objekt hetimi si në formën e përpilimit në lidhje me shkrimet dhe nënshkrimet dhe vulat e shoqërive, dhe në përmbajtje në lidhje me furnizimet (shitjet dhe blerjet) kanë rezultuara tërësisht të fallsifikuara (këto të nënshkruara nga O. D.), dhe përfitimi i vlerës ka qenë xxxx lekë).

Gjykata e Apelit xxxx, me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, ka vendosur Prishjen e vendimin penal Nr.xxxx, datë xxxx, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim kësaj gjykate me tjetër trup gjykues. Në përmbajtje të vendimit në fjalë, pasqyrohet se arsyet e prishjes së këtij vendimi kanë të bëjnë me procedurën e gjykimit, ku i pandehuri ka qenë në mungesë dhe nuk është provuar që ai të kishte dijeni për gjykimin ndaj tij (pra prishja është për procedurë dhe jo për meritë).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit O. D., për veprën penale të parashikuar nga neni 287/1 germa (d), të Kodit Penal, duke e dënuar atë me x vite burgim dhe duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, po për faktin penal sa më lartë.

Po kështu me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, Gjykata e Apelit xxxx ka vendosur prishjen e vendimit nr.xxx, datë xxxx, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx dhe kthimin e akteve për rigjykim. Në përmbajtje të vendimit në fjalë gjykata argumenton se nuk janë respektuar dispozitat për njoftimin e të pandehurit (pra vendimi është prishur për procedurë jo për meritë).

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, ka vijuar me hetimin pasuror ndaj shtetasit O. D. dhe personave familjarë të tij, ku sipas të cilit pasi janë kryer gjatë fazës së hetimeve penale dhe hetimeve pasurore, të gjitha verifikimet pasurore të mundshme, rezulton se personi i mësipërm ka krijuar pasuri që nuk justifikohen me të ardhura të fituara në mënyrë të ligjshme.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se me vendimin nr.x, datë xxxx të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx, është miratuar leje ndërtimi për ndërtimin e objektit “*magazinë+godinë shërbimi x kat dhe zyra*”

x kat”, për truallin në pronësi të shtetasit O. D. dhe me subjekt ndërtues shoqëria “xxxx” sh.p.k. Sipërfaqja e sheshit është xxxx m², ndërsa sipërfaqja e ndërtimit është xxxx m².

Objekti i mësipërm është ndërtuar mbi pasurinë e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xxx, faqe xxx, me sipërfaqe totale xxxx m², tokë arë.

Referuar akteve të dosjes (ku ndër to të pasqyruara edhe në vendimet sa më sipër) rezulton se punimet për ndërtimin e objektit të konfiskimit nuk janë kryer nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, por janë kryer nga vetë pronari i truallit, shtetasi O. D., i pohuar dhe i pranuar edhe nga ky i fundit.

Gjatë hetimit pasuror Prokurori ka urdhëruar kryerjen e një ekspertimi kontabël, (nga ekspertja G. D., e pyetur edhe si dëshmitare gjatë gjykimit, ish-punonjëse në Prokurorinë e Përgjithshme), ku sipas të cilës shtimi i pasurisë për O. D. dhe familjarët e tij për periudhën xxxx-xxxx, ka qenë xxxx lekë, të ardhurat familjare xxxx-xxxx kanë qenë xxxx lekë; rezulton se diferenca mes shtesës së pasurisë dhe të ardhurave është në shumën prej xxxx lekë.

Duke qenë se aktet e ekspertimit (si vlerësues ashtu edhe ai kontabël) gjatë hetimeve ishin bërë pa patur dijeni pala kundër së cilës është kërkuar konfiskimi i pasurisë përkatëse, pa patur mundësi të drejtonin pyetje, të ishin në terren në momentin e verifikimit të objektit etj, mbi kërkesën e palës mbrojtëse, Gjykata në bazë të nenit 363 të K.Pr.Penale, thirri për të pyetur me cilësinë e dëshmitarëve ekspertet që kishin kryer aktet përkatëse (**S. A.** dhe **D. Sh.**, të cilat kanë kryer aktin e ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe ekspertja kontabël **G. D.**). **Sipas dëshmisë së tyre:**

S. A..

Gjykata në respektim të nenit 363 të K.Pr.Penale, i cili referon tek 360 e vijues të të njëjtit kod (në pyetjen e dëshmitarëve), zbatoi procedurën që parashikojnë dispozitat përkatëse.

Dëshmitarja dëshmoi se ajo kishte kryer aktin e ekspertimit Nr.xxxx prot, datë xxxx, së bashku me ekspertin D. Sh.. Sipas saj, nuk kishte patur situacion punimesh por kishin dhënë një opinion për vlerën e tregut, në një farë mënyre bazuar në sa do kushtonte ky objekt po të bëhej me VKM, sipas vlerës së manualit të VKM të atij viti (2012).

Lidhur me faktin që për njërin kat të ndërtesës ajo kishte theksuar se ishin harxhuar xxxx ton hekur, ndërsa në katin tjetër ishin përdorur xxxx ton hekur, ekspertja u shpreh se duhet të ishte gabim material dhe në kushte të tilla bëri dhe korigjimin (duke sjellur automatikisht edhe ndryshim të kostos). Po kështu në këtë akt ekspertimi u konstatuan edhe

disa gabime në vëllimin e punimeve apo vlerat e materjaleve (ku edhe pse nga ekspertja u bënë disa korigjime përsëri palët patën kontestime).

Ajo që theksoi ekspertja kishte të bënte me parashikim (preventiv) punimesh deri sa nuk kishte situacion punimesh. Dëshmitarja dëshmoi se në objekt, ishin vënë pllakat (e porcelanit) ndërsa pala mbrojtëse pretendoi se kjo nuk kishte ndodhur. Ekspertja bëri edhe korigjimet në vlerat përkatëse (sipas saj) duke reflektuar edhe ndryshimet që i koresponduan asaj në TVSH. Sipas saj, ajo kishte përdorur si metodologji atë të kostos sa e ka Enti Kombëtar i Banesave.

D. Sh..

Sipas dëshmitares, ajo kishte realizuar aktin ekspertimit së bashku me S. A., kishte bërë dhe verifikimin e dokumentit të pronësisë që përkon me pozicionin ku është objekti, apo nuk përkon ky lloj objekti, dhe janë verifikuar dhe të gjithë punimet. Për sa i përket rënditjes, përderisa ato nuk kishin projekt konstruksionin dhe projekt arkitekture, të gjitha volumet e punimeve ishin nxjerrë duke parë objektin dhe më pas, volumin e punimeve e kishte rindërtuar ing S.A. e cila ishte eksperte ing ndërtimi. Dhe për vlerësimin e volumeve të cilat i kishte nxjerrë ekspertja tjetër duke marrë VKM e asaj kohe që në 2012, kishte qënë me këto numra analizash, dhe me këto çmime, është nxjerrë ajo kosto sipas aktit të ekspertimit. Detyra e saj ishte vlerësimi i pasurisë por pasi ishin nxjerrë volumet nga ekspertja tjetër. Vlerësimin e pronës e kishin bërë me metodën e kostos në bazë të manualit.

G. D..

Sipas dëshmitares ajo kishte bërë aktin e ekspertimit duke referuar në provat në dosje dhe në aktin e ekspertimit vlerësues të eksperteve të pasurive të paluajtshme. Lidhur me koston e shpenzimit të jetesës, ajo nuk kishte bërë, pasi nuk kishte patur dokumentacion dhe as nuk ishte referuar në të dhënat e INSTAT, po kështu nuk mund të përfshinte në aktin e ekspertimit pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore kur nuk kishte të dhëna (nëse ishte përfituar kundrejt ndonjë akti ligjor kontratë). Ajo në kohën e bërjes së aktit të ekspertimit kishte qënë e punësuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në aktin e ekspertimit ishin përfshirë vetëm provat në dosje pasi nuk kishte patur prova lidhur me të ardhurat e shtetasit O. D. (si paga në institucione të ndryshme etj). Gjithashtu sipas saj, në aktin e ekspertimit nuk ishte përfshirë një faturë e shpenzimeve lidhur me lejen e ndërtimit (pjesë e akteve të dosjes).

I Provat e paraqitura në gjykim nga palët për të vërtetuar pretendimet e tyre (konformë nenit 151 dhe 356 të K.Pr.Penale dhe Ligjit 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar). Gjatë gjykimit u paraqitën disa provat ndër të cilat citohen (një pjesë të tyre u cituan edhe tek rrethanat e faktit dhe nuk po biem në përsëritje):

1. Provat e paraqitura nga Prokuroria.

-Urdhër “Për Regjistrimin e procedimit pasuror” Nr.xxxx, i vitit xxxx, të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, i datës xxxx”, (përmbajtja e të cilit u citua më sipër tek rrethanat e faktit).

- Shkresë nr.xxxx prot datë xxxx, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, dokumentacioni bashkëngjitur (ku ndër to Vendimi Nr.xxxx, datë xxxx, përmbajtja e të cilit u citua sa më sipër).

- Shkresë nr.xxxx prot, datë xxxx e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur(duke vënë në dispozicion dokumentacionin në lidhje me procedimin penal nr.xxxx të vitit xxxx, për veprën penale të parashikuara nga neni 287 të K.Penal, në ngarkim të O. D., ku ndër to:)

-Urdhër për Rregjistrimin e Procedimit Penal, Nr.xxxx, datë xxxx, që bën fjalë për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 gërma “d” i K.Penal, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx (sqsuar sa më sipër).

-Vendimi Nr.xxx, datë xxxx, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, ku sipas të cilit O. D. është dënuar për veprën penale të Fallsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”, më shumë se një herë, dhe në bashkëpunim në bazë të nenit 190/2 të K.Penale.

-Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës datë xxxx, ndaj O. D., kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq etj cituar sa më sipër.

-Vendimi Nr.xxxx, datë xxxx, me të cilin është vënë në sekuestro preventive objekti Magazinë + Godinë Shërbimi në xxxx.

-Procesverbal i kqyrjes së vendit, datë xxxx, bashkangjitur tabela fotografike e objektit që kërkohet të konfiskohet.

-Akt ekspertimi (vlerësues i pasurisë së paluajtshme) datë xxxx, Shkresë nr.xxxx prot dt.xxxx, e Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëngjitur akti i ekspertimit kontabël, ku lidhur me konkluzionet u sqarua sa më sipër.

-Shkresat nr.xxxx prot dt.xxxx, nr.xxxx prot dt.xxxx dhe nr.xxxx prot dt.xxxx të Z.V.Rr.P.P xxxx, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur këtyre shkresave, ndër të tjera Akt Noterjal për pjestimin vullnetar, të pasurive të paluajtshme Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, sipas të cilës është bërë pjestimi vullnetar i pasurisë në bashkëpronësi të shtetasve O. D., H. D. dhe B. D., bashkangjitur kartelat dhe praktika e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu bashkangjitur ka edhe praktikën e pasurisë nr.xxxx, Zona kadastrale xxxx, rregjistruar me datë xxxx, në emër

të O. H. D..

-Ndërsa sa i përket ZRPP vendore të rretheve të tjera në R.Sh, ka rezultuar se O. D. dhe familjarët e tij, nuk kanë pasuri të paluajtshme.

-Në përgjigje të shkresës Nr.xxxx Prot, datë xxxx xxxx Bank, me shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, sqaron se : Shtetasja Sh. D. ka një llogari të hapur në monedhën lek, ndërsa shtetasi O. D., nuk ka llogari.

-Në përgjigje të shkresës Nr.xxxx, datë xxxx (të Prokurorisë së Krime të Rënda), xxxx Bank, me shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, ndër të tjera rezulton se (sipas kësaj banke), shtetasit O. D., Sh. D. dhe familjarët e tyre nuk kanë llogari dhe produkte bankare në xxxx Bank. Po kështu këta persona nuk kanë rezultuar klientë të bankës xxxx bankës xxxx Bank, xxxx Bank, xxxx bank, xxxx Bank, xxxx Bank, xxxx Bank, xxxx Bank,

-Ndërsa në xxxx Bank dhe xxxx Bank, nuk rezulton të kenë llogari O. dhe Sh. D. por A.D. (vajza) duke paraqitur dhe informacion bankar për këtë llogari.

-Në përgjigje të shkresës Nr.xxxx, datë xxxx (të Prokurorisë së Krime të Rënda), Banka xxxx, me shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, ndër të tjera rezulton se (sipas kësaj banke), shtetasit O. Sh., A.E.E D. kanë llogari bankare pranë kësaj banke, duke bashkangjitur informacioni bankar për këto llogari.

-Në përgjigje të shkresës Nr.xxxx, datë xxxx (të Prokurorisë së Krime të Rënda), xxxx Bank, me shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, ndër të tjera rezulton se (sipas kësaj banke), shtetasit O. D. dhe Sh. D., kanë qenë klient të kësaj banke, duke bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

-Në përgjigje të shkresës Nr.xxxx, datë xxxx, xxxx, me shkresën Nr.xxxx Prot, datë xxxx, ndër të tjera rezulton se (sipas kësaj banke), shtetasja Sh. D., ka depozita dhe llogari (ndërsa O. D. dhe personat e tjera nuk kanë llogari apo të jenë klientë të saj) duke bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

-Me Shkresën nr.xxxx prot dt.xxxx, e Këshillit të Qarkut xxxx, ka vënë në dispozicion leje sheshi Vendimi i KRRT nr.xxxx datë xxxx; leje ndërtimi Vendimi i KRRT nr.xxxx datë xxxx; certifikatë pronësie bashkëngjitur harta treguese; planvendosje e sheshit; kontratë sipërmarrje nr.xxxx rep xxxx kol datë xxxx; bashkëngjitur çertifikatë NIPT; liçensë shoqëria xxxx; liçensë P. T.; shkresë me nr.xxxx prot datë xxxx e titulluar “Mbi pagesën e detyrimit financiar për subjektet që përfitojnë leje ndërtimi”; faturë arkëtimi; preventiv;

deklaratë e ing A.A.; lidhja e objektit me infrastrukturën;

-Shkresa me nr.xxxx prot datë xxxx, kthim përgjigje, e Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve Liçensimit dhe Çertifikimit; sipas së cilës E.D. ka në pronësi mjetin me targë xxxx; bashkëngjitur praktika lidhur me këtë automjet.

-Sipas shkresës me nr.xxxx prot datë xxxx, lëshuar nga DRSSH xxxx rezulton se; Sh. D. është e punësuar pranë subjektit Qendra e Transformimit Teknologjie Bujqësore ndërsa O. D. dhe të tjerët nuk janë persona të siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi si dhe nuk janë persona të siguruar vullnetarisht.

-Me shkresën Nr.xxxx, datë xxxx, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve xxxx, sqaron se shtetasit (e familjes D.), nuk figurojnë të rregjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

-Shkresa me nr.xxxx prot datë xxxx, sipas së cilës rezulton se noterja ka vënë në dispozicion të Prokurorisë kontratë qeraje me nr.xxxx rep xxxx kol datë xxxx.

-Shkresa me nr.xxxx prot datë xxxx, e lëshuar nga Aluizni, rezulton se O. D. ka vetëdeklaruar për legalizim, për objekt informal, (banesë private) bashkëngjitur praktika përkatëse.

-Me vendimin nr.xxx datë xxxx Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme magazine+godinë shërbimi xx kat dhe zyra xx kat, e ndodhur mbi pasurinë e paluajtshme nr.xxxx zona kadastrale nr.xxxx në fshatin xxxx.

-Shkresë Nr.xxxx, prot, datë xxxx, me të cilën i janë vënë në dispozicion kopje të akteve të ekspertimit tekniko-grafik, me numër xxxx, datë xxxx dhe xxxx, datë xxxx, të Procedimit penal nr.xxxx të vitit xxxx, lëshuar nga Prokuroria xxxx. Aktet e ekspertimit në fjalë pasqyrojnë faturat e ekspertuara nga ekspertët grafik, ku ka rezultuar se të xxx faturat objekt ekspertimi (janë të cituara që të gjitha), janë shkruar nga O. D., krahasuar me modelet e paraqitura në emër të tij. Ndërsa këto fatura ka rezultuar se nuk janë nënshkruar nga personat në emër të të cilëve kanë dalur (pra kanë qenë të fallsifikuara në formë dhe përmbajtje).

2.Provat dhe aktet e paraqitura nga mbrojtja.

-(Lidhur me provat të cilat janë paraqitur edhe nga Prokuroria nuk po përmenden edhe një herë për të mos rënë në përsëritje).

-Kontratë Huaje Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, e lidhur ndërmjet shtetasve B. D. si huadhënës dhe shtetasve H. S. D. dhe A. A. D., sipas të cilët ndër të tjera pasqyrohet: *Huadhënësi deklaron se jashtë kësaj zyre noterjale dhe konkretisht sot i kam dhënë hua, huamarrësve H. D. dhe A.*

D. shumën prej xxxx (xxxx) euro me kusht që të gjith këtë shumë të marrë jashtë kësaj zyre të ma ktheje brenda x viteve nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.Huamarrësit H. D. dhe A. D. deklarojnë se jashtë kësaj zyre noterjale dhe konkretisht sot i kanë marrë hua huadhënësit B. D. shumën prej xxxx (xxxx) euro...është dhënë hua pa asnjë interes....

-Prokurë e posaçme Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, hartuar para noterit Sh. Gj., sipas të cilës: *të përfaqësuarit H. D., A. D., N. D., i japin tagër përfaqësuesit të tyre O. D. që të përfaqësojë palët në sipërmarrje për ndërtimin e një objekti kapanon x kat dhe x kat zyra në 1.Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për ndërtimin e kapanonit:2.Nxierrjen e lejes së sheshit të ndërtimit:3.Nxierrjen e lejes së ndërtimit:4Autorizim Ambjenti:5.Kontratë të energjisë elektrike..”*

Sipas prokurës në fjalë, ndër të tjera O. D. autorizohet të kryejë në emër dhe përlllogari të të përfaqësuarve (çdo veprim, blerje, furnizim) lëvizjet materjale dhe monetare duke marrë edhe miratimin e palëve.

-Kontratë Huaje, (e thjeshtë jo noterjale), lidhur ndërmjet huadhënësi N. H. D., dhe huamarrës R. F. Gj., datë xxxx, sipas të cilës huadhënësi jep shumën prej xxxx (xxxx) lekë, për një periudhë prej xx muaj. Si garanci për shlyerjen e huasë huamarrësi ka vënë si garanci disa paisje makinerie.

-Leje shesh ndërtimi sipas vendimit Nr.xxx, datë xxxx, të K.RR.T’së, duke u miratuar sheshi i ndërtimit, destinacioni dhe funksionet e tij për objektin :Magazinë + Godinë Shërbimi x Kat, **xxxx, me sipërfaqe të sheshit xxxx m², sipërfaqe e ndërtimit xxxx m², me kondicionet përkatëse.**

- Leje Ndërtimi Nr.xxx, datë xxxx, për objektin: Magazinë + Godinë Shërbimi x Kat, **xxxx, me afat përfundimi xxxx, sipas kondicioneve të vendimit nr.xxx, datë xxxx.**

-Shpenzimet e realizuara (një akt privat), ku pasqyrohet vlera pjesore e situacionit (ndërmjet sipërmarrësve dhe xxxx Shpk).

-Detyrimet ndaj të tretëve për vitet xxxx, akt privat, i hartuar në të cilin pasqyrohen shpenzimet dhe detyrimet ndaj të tretëve (duke listuar disa persona që ju kanë detyrime sipas faturave për ndërtimin e kapanonit), në shumën prej xxxx lekë, për një afat x vjeçarë.

-Vërtetim nga baza e vlerësueshme lëshuar nga Dega e Tatim taksave xxxx, për periudhën xxxx, për O. D., pagat për periudhën xxxx, për O. D. (duke dhënë vlerat përkatëse.

-Fatura Fletë –Dalje (të thjeshta nga blloqe faturash, të pa vulosura dhe të pakonfirmuar nga institucionet përkatëse gjithsej xxx (xxxx) ku sipas personit ndaj të cilit kërkohet konfiskimi i pasurive objekt gjykimi me këto fatuara pasqyrohen shpenzimet për blerjen e materjaleve për ndërtimin e objektit në fjalë.

-Vërtetim Nr.xxxx, datë xxxx, sipas të cilit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxxx, është në gjykim çështja civile Nr.xxxx Regj, datë xxxx, sipas të cilës H. D. si paditës me të paditur O. D. etj me objekt përjashtim nga sekuestro, e cila është e pezulluar.

-Deklaratë Noterjale Nr.2036 Rep, Nr.1082 Kol, datë 21.04.2016, në të cilën pasqyrohet ndër të tjera se: *Shtetasit A. M. dhe D. K., të cilat kanë deklaruar se kanë qenë përfitues të tokës bujqësore në bazë të ligjit 7501, për tokën, ndër të tjera pjesërisht edhe për pasurinë nr.xxxx, me sipërfaqe xxxx m², në zonën kadastrale xxxx...Duke qenë se historikisht kemi patur marrëdhënie të mira miqësore dhe shoqërore, deklarojmë se Kontratën e Shitblerjes sa i përket kësaj pasurie e kemi bërë thjeshtë për efekt dokumentacioni dhe nuk kemi marrë asnjë kundërshpërblim nga blerësi (djali i pronarit të vjetër) O.D.*

-Statement nga xxxx Bank, lidhur me H. D., Sh. D., . D., Statement nga xxxx Bank për S. D..

-Deklaratë Huadhënie, (deklaratë private), ndërmjet Huadhënës D. Q. dhe huamarës H. S. D. dhe O. D., për një shumë prej xxxx lekë, me afat x vjeçar, që mban datë xxxx. Deklaratë Huadhënie ndërmjet Huadhënës M. I. B. dhe huamarrës H. S. D., O. D., në shumën prej xxxx (xxxx) lekë për një afat prej x (xxxx) vite, e datës xxxx, deri më datë xxxx.

-Kontratë Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, ndërmjet Sipërmarrësit Shoqëria xxxx shpk, me NIPT xxxx, me drejtues ligjor F. R., me porositës O. D., sipas të cilit porositësi (Investitori) O. D., pronar i pasurisë xxxx, Zona kadastrale xxxx, në një sipërfaqe toke prej xxxx m², me adresë xxxx. Sipas kontratës në fjalë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, ku për tu theksuar është fakti që i vetmi investitor (porositës) është O. D., me shpenzimet e veta, duke vënë në dispozicion pasurinë mbi të cilën do të ndërtohej.

-Vërtetim Nr.xxx, datë xxxx, lëshuar nga Qendra e transferimit të teknologjive Bujqësore xxxx, sipas të cilës Sh. D., ka një pagë mujore neto prej xxxx lekë. Vërtetim Nr.xxxx Prot, datë xxxx, për Sh. D., duke dhënë të dhëna lidhur me pagesën mujore për vitet xxxx.

-çertifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr.xxxx, për xxxx m², në emër të H. D., Nr.xxxx, në emër të H. D., për Pasurinë nr.xxxx, për H. D., Akti i marrjes së Tokës në Pronësi për H. D., për xxxx m², xxxx, për O. D., për marjen e xxxx m².

-çertifikata familjare, etj.

-Vërtetim me nr.xxxx prot datë xxxx, për H. D. që trajtohet me pension pleqërie.

-Vërtetim me nr.xxxx prot datë xxxx, për shtetasen L. D. për pagesë për aftësi të kufizuar.

-Vërtetim me nr.xxxx prot datë xxxx, për shtetasen H. A. për pension pleqërie xxxx.

-Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto për A. D. për periudhën xxxx.

Vërtetim page me nr.xxxx prot datë xxxx, për shtetasin N. D..

-Vërtetim page për shtetasin N. D. periudha xxxx.

-Vërtetim me nr.xxxx datë xxxx, për shtetasin N. D..

-Vërtetim me nr.xxxx, prot datë xxxx, për shtetasin N. D..

-Vërtetim page për shtetasin N. D. për vitin xxxx.

-Vërtetim nr.extra prot datë xxxx, për shtetasin N. D., lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

-Vërtetim nr.extra prot datë xxxx, për shtetasin N. D., lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

-Kontratë “Akt-Marrëveshja” Nr.xxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, me nënshkruesit janë **H. D., A. D., O. D., dhe N. D.** ku theksohet se: *...palët kanë rënë dakort për të drejtat e detyrimet në lidhje me ndërtimin e një kabanoni x kat dhe zyra për administratën x kat në tokën e trashëguar nga të parët në pronësi të tyre...që kanë rënë dakort që të drejtën e pronësisë ta ndajnë me nga xxxx m² seicili... duke përcaktuar përqindjen e aseteve në ndërtim ku O. D. ka x %...”.*

-Lidhur me vendimet gjyqësore duke qenë se u përmendën më sipër nuk po biem në përsëritje, referoju tek rrethanat e faktit.

II.3. Kryerja e ekspertimeve, me kërkesë të palëve gjatë gjykimit.

Që në fillim të këtij gjykimi, avokati L. M. përfaqësues i personave të tretë H. D., N. D. dhe A. D., kërkoi kryerjen e një ekspertimi kontabël dhe vlerësues të pasurive objekt konfiskimi në këtë gjykim, pasi aktet e ekspertimit të kryera

më parë ishin të njëanshëm, kishin pasaktësi dhe këto palë nuk kishin patur mundësi të bënin mbrojtje sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës kundër të cilit kërkohet konfiskimi i pasurisë fillimisht kërkoi që të thirreshin ekspertët që kishin bërë ekspertimin vlerësues dhe kontabël që të pyeteshin gjatë gjykimit. Gjykata me vendim të ndërmjetëm lejoi thirrjen e ekspertëve që kishin bërë ekspertimet përkatëse, ku u pyeten me cilësinë e dëshmitarëve (në respektim të nenit 263 e vijues të K.Pr.Penale, cituar sa më sipër dëshmia e tyre).

Gjatë pyetjes së tyre rezultoi se kishte patur disa pasaktësi në llogaritjen e volumit të punimeve dhe për pasojë edhe në llogaritjen e vlerave të shpenzimeve (etj), ku megjithëse u bënë disa saktësime, nga palët (përfaqësuesi i O. D. dhe personave të tretë) u kërkua kryerja e një ekspertimi si vlerësues ashtu edhe kontabël (janë të ndërvarur në gjykime të tilla), ekspertët nuk ju ishin njoftuar palëve që tërheqin interesa në këtë pasuri, nuk kishin patur mundësi të bënin pyetje, të ishin të pranishëm kur kishin qenë në terren, për më tepër ekspertja kontabël kishte qenë punonjëse e Prokurorisë së Përgjithshme, duke sjell edhe dyshime për njëanshmëri.

Nga ana e Prokurorit u mbajt qëndrimi se nuk ishte e nevojshme kryerja e një ekspertimi të ri, pasi aktet e ekspertimit të kryera gjatë hetimeve dhe sqarimet që bënë ekspertet në gjykim plotësonte kërkesat e ligjit në rastin konkret.

Gjykata, në bazë të neneve 178, 179 të Kodit të Procedurës Penale në përputhje me ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” nenet 21, 23, 24 të tij, pranoi kërkesën e përfaqësuesit të palës kundër të cilës është kërkuar konfiskimi i pasurisë dhe personave të tretë për të thërritur një ekspert kontabël dhe një ekspert vlerësues të pasurive, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes financiare dhe vlerën e pasurive për të cilat kërkohet konfiskimi.

Gjykata pasi pyeti palët lidhur me detyrat, në respektim të nenit 183, 366, 185 të K.Pr.Penale, dhe ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, duke u bazuar në provat të dosjes për këtë çështje (si dhe verifikimet që do të bëheshin në terren) ju caktoi ekspertëve detyra për kryerjen e ekspertimit (ndër të tjera vlerësimin e ndërtesës objekt konfiskimi, koston e ndërtimit, situata financiare e O. D. dhe familjarëve të tij para përfshirjes në veprimtari kriminale, pra cila kishte qenë situata financiare e tij në datë xxxx, të ardhurat financiare, shpenzimet, diferenca e tyre nga data xxxx-xxxx, të tij dhe familjes së tij si dhe të personave të tretë, për më tepër referoju vendimit përkatës).

Në Aktin e Ekspertimit Vlerësues (Teknik), i pasurisë së paluajtshme objekt konfiskimi, përshkruhet vendodhja e kësaj prone dhe përshkrimi (për të tepër referoju aktit të ekspertimit pjesë e dosjes). Nga ana e Ekspertes, është bërë përlllogaritja e vlerës së pronës, ku në bazë të matjeve në terren është hartuar librezja e masave duke nxjerrë volumet përkatëse. Kjo pasi nuk ka volume punimesh, por vetëm preventiv nga i cili nuk rezulton që punimet të ishin kryer nga ndonjë subjekt ku të mbahej dokumentacion përkatës (volum punimesh, supërvizor, marrje në dorëzim etj).

Lidhur me disa fatura të paraqitura nga O. D., sipas ekspertes citohet: *nuk janë marrë në konsideratë dhe arsyeja është se në analizat e çmimeve të vitit xxx-xxxx, që unë kam marrë në konsideratë në analizat, është një analizë e tregut të lirë, dhe në këtë moment mua si vlerësuese jam thirrur për tregun e lirë ... nuk janë në formën e një fature të rregullt tatimore, është kopja e dytë nuk është kopja e parë...’.*

Sipas ekspertes, duke qenë se nuk kishte dokumentacion ligjor se kush i kishte bërë punimet, ka hartuar dy variante të aktit të ekspertimit. Në variantin e parë ka nxjerrë vlerën duke mos përfshirë sigurimet shoqërore të punonjësve që mund të kenë bërë punimet, si dhe në variantin e dytë duke marrë parasysh çmimet e manualeve të ndërtimeve (sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fushën e ndërtimeve) që ishte në fuqi, i miratuar për periudhën kur janë kryer ndërtimet (pra për vitin xxxx).

Gjithashtu sipas ekspertes është përdorur metoda e çmimit të volumeve të punimeve (sipas përlllogaritjes së saj), dhe nuk janë marrë çmimet mesatare të entit të banesave. Kjo pasi ndërtimi objekt konfiskimi është i një natyre të veçantë, nuk ka mure të brendshme, nuk kemi të bëjmë me banim dhe kosto për metër katror në rastin konkret është më e ulët se ajo e llogaritur sipas entit të banesave për metër katror.

Sipas ekspertes në variantet që ajo ka paraqitur nuk janë përfshirë TVSH. Sipas saj në dosje nuk ka një dokument që tregon se TVSH nuk është paguar, por nuk kishte fatura (ligjore) për TVSH. Lidhur më faktin se si mund të paguhet kjo TVSH, ajo sqaroi se individi e paguan atë në momentin që shkon për të rregjistruar objektin, kur nuk ka fatura ligjore TVSH, që do të mbahet në momentin e rregjistrimit.

Përfundimisht sipas ekspertes vlera e objektit ndërtimor objekt konfiskimi është:

Varianti 1 (pa përfshirë sigurimet shoqërore) xxxx lekë.

Varianti 2 (sipas vlerës të çmimit të manualeve të vitit xxxx, e zbrërthyer më volumin e punimeve) xxxx lekë. Nëse do të paguhej TVSH (e cituar në seancë dhe e fiksuar në procesverbal) do të kishim: Varianti 1 (pa përfshirë sigurimet shoqërore) xxxx lekë+ **xxxx TVSh, do të kishim vlerën totale prej xxxx** lekë. Varianti 2 (sipas vlerës të çmimit të manualeve të vitit xxxx, e zbrërthyer më volumin e

punimeve) xxxx lekë+xxxx lekë, do të kishim vlerën në total prej xxxx lekë.

-Ndërsa sipas aktit të ekspertimit Kontabël, hartuar nga Eksperti I. Ll., mbi bazën e detyrave të lëna nga Gjykata (cituar sa më sipër dhe për më hollësisht referoju vendimit për caktimin e detyrave pjesë e akteve të dosjes): ndër të tjera pasqyrohet se:

-Sipas Ekspertit, gjendja financiare e familjes së O. D. me datë xxxx është xxxx lekë, shumë e cila e ndarë sipas varianteve sa më lartë me dhe pa TVSH kemi (varianti 1, pa TVSH xxxx

lekë/xxxx/x%=x%	të investimit;	me TVSH	xxxx
lekë/xxxx/x%=x %;	varianti II,	pa TVSH	xxxx
lekë/xxxx/x%=x%;	me	TVSH	xxxx

lekë/xxxx x%=x% të investimit).

-Të ardhurat (pagat e O. D. dhe Sh. D.) nga data xxxx-xxxx, është xxxx lekë. Duke qenë se palët nuk paraqitën të dhëna apo prova mbi shpenzimet familjare për periudhën e hetimit pasuror, eksperti i është referuar të dhënave zyrtare që i ka ofruar INSTAT (pas komunikimit të tij me këtë institucion), janë vënë në dispozicion shpenzimet mesatare mujore për x % të familjeve me shpenzime më të ulta. Eksperti referuar çertifikatës së përbërjes familjare të kohës së hetimit pasuror me të dhënat që i ka ofruar INSTAT sa më sipër për periudhën xxxx-xxxx, ka nxierr në total si shpenzime për këtë familje me x anëtarë (familja O. D.) xxxx lekë.

Diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve është xxxx lekë.

Investimet e kryera sipas aktit të ekspertimit të ekspertit vlerësues: Rasti (varianti) i parë pa TVSH është xxxx lekë, që përbën xx % të investimit; me TVSH është xxxx lekë që përbën xxx% të investimit; rasti (varianti) i dytë, pa TVSH xxxx lekë, që përbën xx % të investimit; me TVSH xxxx lekë që përbën xxx% të investimit.

Për H. D. diferenca nga të ardhurat dhe shpenzimet (të ardhurat dhe shpenzimet i ka paraqitur në mënyrë të hollësishme në aktin e ekspertimit të tij dhe familjes) xxxx lekë, dhe sipas varianteve (cituar sa më sipër pa dhe me TVSH) janë xx %, xx %, xx %, xx %; Për N. D., diferenca nga të ardhurat me shpenzimet është xxxx lekë dhe sipas varianteve përbën xxx %, xxx%, xxx %, xxx %; Për A. D., kishte diferencë negative, më shumë shpenzime se të ardhura, pa patur mundësi të merrte pjesë në investim; dhe sipas ekspertit po të merreshin të ardhurat e të gjitha palëve sëbashku me tre variantet (1-3) mbulojnë mbi x % të investimit, dhe vetëm në variantin e 4 mbulohet x %.

III. Pretendimet dhe prapsimet e palëve në gjykim (në mënyrë të përmbledhur)

Prokuroria (pala që ka iniciuar procesin në rastin në gjykim që përfaqëson interesat e shtetit), si në kërkesën për gjykim ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje (por edhe në konkluzionet përfundimtare), mbajti qëndrimin se: në rastin konkret plotësohen të gjitha kërkesat e ligjit 10192/2009, i ndryshuar lidhur me pasurinë objekt konfiskimi (megjithëse në objektin e kërimit kërkonte sekuestrimin e xxxx m², ndërsa në pretendimet përfundimtare kërkoi konfiskimin e xxxx m²), pasuria është vënë vetëm me kontributin e O. D., ajo është vënë gjatë kohës së përfshirjen në veprimtarinë kriminale të O. D., personat e tretë nuk kanë marrë pjesë në këtë investim, investimi nuk i përgjigjet dukshëm të ardhurave të ligjshme të O. D. dhe familjes së tij.

Gjithashtu sipas Prokurorit, faturat e paraqitura gjatë gjykimit, provat e palëve të treta nuk kanë vlerën e provave, faturat nuk kanë formën dhe as përmbajtjen që kërkojnë faturat tatimore, O. D. dhe Sh. D. justifikojnë vetëm xxx % të investimit të kryer, dhe se duhet të konfiskohet xxx % e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore.

Palët e treta nuk provuan të kenë marrë pjesë në këtë investim, kjo pasi pasuria e paluajtshme ku është ndërtuar objekti është vetëm në emër të O. D., referuar dokumentacionit dhe lejes së ndërtimit ajo ka dalur vetëm në emër të O. D., kontrata për dhënien me qera të këtij objekti është bërë vetëm nga ai, punimet për ndërtimin e objektit kanë përfunduar para datës xxxx, kur është bërë kqyrja e objekteve nga OPGJ, ndërkohë që kontrata dhe aktet e tjera mbajnë data të mëvonshme. Prokurori theksoi se vlera provuese e shkresave private dhe të thjeshta nuk mund të kenë vlerë provuese tej atyre të paraqitura nga kjo palë, ato mund të marrin vlerë provuese në favor të përpiluesit vetëm kur ata e paraqet pala kundërshtarë.

Personi ndaj të cilit u kërkua konfiskim shtetasi O. D. nëpërmjet përfaqësuesit ligjorë të tij parashtroi gjatë hetimit gjyqësor dhe në konkluzione përfundimtare:

Kërkesa e Prokurorit duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova. Gjatë gjykimit është provuar se ndërtimi është bërë me kontributin e disa personave pavarësisht se veprimet administrative janë kryer nga O. D., (në mënyrë të përmbledhur avokati paraqet rrethanat e faktit si në kërkesën për gjykim nga prokurori).

Sendi nuk është i lirë në qarkullimin juridiko-civil, nuk mund të tjetërsohet, dhe nuk mund të kërkohet konfiskimi i tij. Në interpretim të

këtij argumenti pala mbrojtëse referon në vendimin Unifikues Nr.xx, datë xxxx, ku duke qenë se shtesa ose ndërtimi është realizuar në kundërshtim me normat në fuqi dhe nuk është rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme nuk mund të jetë objekt pjestimi gjyqësor.

Pasuria e paluajtshme mbi të cilin është ndërtuar objekti është përfituar para vitit xxxx, dhe se e tillë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor.

O. D., ka vepruar në emër të katër pjestarëve të tjerë, kjo pasi leja e ndërtimit nuk mund të dilte në emër të të gjithëve dhe kjo është bërë në mirëbesim, dhe se duhet të merret parasysh akt-marrëveshja nr.xx, datë xxxx.

Palët e treta kanë ngritur një padi për përjashtim nga sekuestro preventive në Gjykatë, por që është pezulluar deri në përfundim të shqyrtimit të këtij gjykimi.

Objekti është ndërtuar nga vetë O. D., dhe jo me ndonjë subjekt juridik, objekti është pa leje, i pa rregjistruar pasi nuk janë respektuar kushtet ligjore të lejes.

Palët e treta janë ortakë në këtë ndërtim, sipas aktit të ekspertimit të ardhurat e tyre mbulojnë shpenzimet dhe investimin. TVSh sipas ekspertës nuk është paguar, nuk janë paguar sigurimet shoqërore, dhe se gjykata sipas varianteve të paraqitur nga ekspertet, duhet të marrë në konsiderat variantin 1, (pa paguar sigurimet shoqërore dhe pa u paguar TVSH, ku të ardhurat e të gjitha palëve mbulojnë xxx % të investimit.

Lidhur me Personin e tretë Sh. D., ngrihen pretendime të përbashkëta si O. D., por në veçanti shprehet se pretendimet e Prokurorisë nuk mund të përfshijnë pasurinë e Sh. D., (duke referuar në dispozitat e K.Familjes pretendon se ajo është bashkëpronare në gjysmën e pasurisë së vënë nga O. D., edhe pse nuk është transkriptuar në emër të saj.

Personat e tretë H. D., A. D. dhe N. D. nëpërmjet avokatit L. M., mbajtën qëndrimin se sendi objekt konfiskimi është ndërtuar me kontributin e të gjithë pjesmarrësve (O., H., N. dhe A.).

-Me vendimin nr.xxx, datë xxxx, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx është vendosur sekuestro Preventive mbi objektin Magazinë +godinë shërbimi në fshtin xxxx, palët e treta janë në proces gjyqësor ku kanë kërkuar përjashtimin nga sekuestroja të pjesës së tyre takuese ku gjykimi i çeshtjes civile është pezulluar.

-O. D., ka vepruar thjeshtë si përfaqësues i palëve të treta, ku fillimisht ka patur mirëkuptimin dhe mirëbesimin verbal dhe më pas është konkretizuar me prokurë me datë xxxx.

-Pasuria me numër xxxx, që është certifikatë në emër të O.

D., thjeshtë është bërë transkriptimi me këtë emër por kontributi i tij është i pa përfillshëm në raport me kontributin e personave të tretë. Nga ana e Gjykatës duhet të mbahet parasysh akt-marrveshja për pjemarrje në investim ku O. D. ka vetëm x % të investimit.

-Palët investuese kanë një sërë detyrimesh ndaj të tretëve. Edhe O. D. për pjesën që ka investuar në objekt e justifikon me të ardhura të ligjshme të tij dhe familjes. Palët e treta dhe familjarët e tyre kanë krijuar të ardhura të ligjshme ndër to në familjet bujqësore.

Nga ana e ekspertës janë përfshirë në vlerën e çmimeve edhe punime që nuk janë realizuar në objekt. Ndërsa referuar ekspertimit kontabël të ardhurat e personave të tretë dhe O. D. arrin në xxx % të investimit. Vetëm të ardhurat e A., H. dhe N. D. përbën x % të vlerës së investimit pa përfshirë kontributin e O. D..

IV. Analiza Ligjore.

Në nenin 1 të Ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar përcaktohet se:

Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin dhe korrupsionin, si dhe në kryerjen e krimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 2 të po këtij ligji “Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe krimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale”.

Ndër sa në nenin 3/1 të ligjit në fjalë jepet fusha e zbatimit të këtij ligji ku ndër të tjera sanksionohet se: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal”c) ...ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal”...

Në pikën 2 të po këtij neni parashikohet ndër të tjera se: Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;..

Në pikën 6: Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të

rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

Në interpretim të dispozitave sa më sipër (por jo vetëm), Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga organi i akuzës për konfiskimin e pasurive sipas objekti të kërkesë (cituar sa më lartë) përfshihet në fushëzbatimin e këtij ligji.

Pra sipas ligjit, bien në fushëzbatimin e tij pasuritë e personave për të cilët ka një dyshimi të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në një nga veprat e listuara në këtë dispozitë (neni 3/1 të ligjit).

Tek rrethanat e faktit, u pasqyrua se në vijim të verifikimeve pasurore të kryera nga organi i akuzës ka rezultuar se në kuadër të hetimeve paraprake të procedimit penal nr.xxxx viti xxxx të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, shtetasi O. D. është akuzuar se ka kryer veprën penale “*pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287/1, gërma (d) e Kodit Penal.

Përsa i përket faktit penal për veprën penale për të cilën është akuzuar O. D., ka rezultuar se në kohën kur ai kishte qenë me detyrën e Inspektorit të Kontrollit Tatimor pranë Degës së Tatimeve xxxx, (në periudhën xxxx-xxxx), kishte kontakte me disa subjekte juridike. Pas largimit si inspektor ai nëpërmjet fallsifikimit të faturave TVSh-ve, duke përshkruar transaksione të pavërteta, në bashkëpunim me persona të tjerë, ka përfituar një shumë prej xxxx lekë.

Gjatë vitit xxxx, ka kryer kontrole tatimore në subjektin xxx.shpk, dhe pas largimit nga detyra në vitet xxxx në cilësinë e ekonomistit të subjekteve xxxx, shpk, xxxx shpk, dhe xxx.shpk, me selin në xxxx, ka tërhequr në emër të tyre x blloqe (me nga x fatuara seicila), fatura tatimore TVSh-je.

Faturat e TVSh-së nuk rezulton të jenë plotësuar në emër të këtyre subjekteve si shitës, por në emër të disa subjekteve të tjerë duke pasqyruar të dhëna të rreme, si në formë dhe në përmbajtje me qëllim për të përfituar në mënyrë të paligjshme kreditimin e Tatimit mbi vlerën e shtuar. Në lidhje me këto fakte penale shtetasi O. D., është dërguar në gjyq për veprën penale të “Fallsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda parashikuar nga neni 190/2 të K.Penal.

Gjykata e Shkallës e Rrethit Gjyqësor xxxx me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, ka vendosur ndër të tjera “Deklarimin Fajtor të të pandehurit O. D. për veprën penale të të Fallsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, më shumë se një herë, dhe në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 190/2 të K.Penale dënimin e tij me x vite burg.

Me vendimin e datës xxxx, nga Prokuroria e Rrethit xxxx, O. D. i është komunikuar akuza, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal (dhe më pas duke dërguar çështjen për gjykim).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, (gjykim i zhvilluar në mungesë të të pandehurit O. D.), ka vendosur ndër të tjera: Deklarimin fajtor të të pandehurit O. D., për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal, duke e dënuar me x vite burgim. Konfiskimin e objektit të sekuestruar me vendimin Nr.xxx, datë xxxx, për vlerën xxxx lekë.

Duke qenë se është bërë gjykimi në mungesë Gjykatat e Apelit kanë prishur vendimet në fjalë (për procedurë pas i pandehuri është gjykuar në mungesë), dhe e ka kthyer për rigjykim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me vendimin Nr.xxx, datë xxxx, (në prani të avokatit të zgjedhur nga i pandehuri) ka vendosur Deklarimin fajtor të pandehurit O. D., për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” i K.Penal, duke e dënuar me x vite burgim, dhe në bazë të nenit

59 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë prej x vitesh.

Gjithashtu Gjykata e Apelit xxxx ka prishur për procedurë (shkelje e dispozitave mbi njoftimin e të pandehurit në mungesë) vendimin Nr. Nr.xxxx, datë xxxx, dhe e ka kthyer për rigjykim.

Ajo që vërehet në të gjitha aktet dhe vendimet gjyqësore në fjalë referohen akteve teknik-grafik (të marrë si prova në ato gjykime cituar sa më lartë tek provat shkresore), ka rezultuar se x faturat kanë qenë tërësisht të fallsifikuara, dhe se të x faturat e TVSh, janë shkruar dhe nënshkruar nga O. D..

Në fushëzbatimin e këtij ligji përfshihen edhe pasuritë: a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta.

Në rastin konkret, gjatë gjykimit ndër të tjera rezultoi se pasuria objekt konfiskimi, është në zotërim të drejtpërdrejtë nga O. D., objekti i ndërtuar mbi pasurinë me numër xxxx Zona Kadastrale xxxx Vol.xx, fq.xxx.

Gjithashtu sipas nenit 3 të ligjit në fjalë, në fushëzbatimin e ligjit (dhe për pasojë subjekte të tij) bien jo vetëm pasuritë e zotëruar drejtpërsëdrejtë, apo tërthorazi nga personi subjekt i ligjit, por edhe : pasuritë e personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të

paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, u provua plotësisht se ka dyshime të arsyeshme (madje tejkalon indicjet pasi me akte ekspertimi teknik-grafik, është provuar fallsiteti i fatuarave, me vendime gjyqësore ndonëse jo të formës së prerë, por që japin të dhëna të mjaftueshme lidhur me faktet penal dhe veprimet konkrete të kryer nga O. D.), të bazuara jo vetëm në indicje por në prova, se O. D. është përfshirë në veprimtari kriminale konkretisht në veprën penale të listuar nga neni 3 paragrafi 1 (pika ç,) të ligjit 10192/2009 i ndryshuar, dhe se shtetasi O. D. është subjekt i këtij ligji.

Neni 24 i ligjit në fjalë në pikën 3, parashikon se edhe kur procedimi penal pushohet ose i pandehuri deklarohet i pafajshëm, pasuria i nënshtrohet konfiskimit (për subjektin e ligjit sipas nenit 3 pika 1), me përjashtim të rasteve kur a) fakti nuk ekziston, b) fakti nuk përbën veprë penale, c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale. Në rastin konkret edhe pse nuk kemi një vendim të formës së prerë, gjykata çmon se ka një sërë indicjesh dhe provash mbi bazën e të cilave mbështetet dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale sipas nenit 287 të K.Penal, nga subjekti i këtij ligji.

Por në interpretim të ligjit sa më sipër, nuk mjafton vetëm që shtetasi për të cilin kërkohet konfiskimi i pasurisë të jetë subjekt i këtij ligji, dhe fushëzbatimi i ligjit, por kondicionohen edhe kushte të tjera që parashikohen shprehimisht në nenin 24/1 i ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 i ndryshuar.

Kështu në nenin 24 paragrafi 1 parashkohet shprehimisht:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicje, për pjesëmarrje të personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;
- b) rezulton se pasuria është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;
- c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat e përmendur në nenin 3, të këtij ligji, nuk arrijnë të përlligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre”.

Lidhur me kondicionin (kushtin)e parë (pika (a) e paragrafi 1 e këtij neni) u arsyetua sa më lartë se në rastin konkret dyshimet e bazuara janë jo vetëm në indicje por edhe në prova, duke përcaktuar rrethanat e përfshirjes

në këtë veprimtari, shkeljen e dispozitave përkatëse, kohën kur është përfshirë (për të mos rënë në përsëritje referoju tek argumentimi i subjektit dhe rrethanat e faktit).

Përsa i përket pasurisë objekt konfiskimi dhe prejardhjes së tyre sipas pikës b) paragrafi 1, neni 24 i ligjit.

Gjykata çmon se për tu konsideruar se të ardhurat e një personi kanë qenë të ligjshme për tu marrë parasysht konformë nenit **24/1/b të ligjit 10192/2009, i ndryshuar**, këto të ardhura duhet të pasqyroheshin nga të dhënat që nxirren nga organet e tatim/taksave, pasuri nga trashëgimia apo aktiviteti ekonomik i evidentuar nga organet kompetente, dhe jo çdo “aktivitet i supozuar” pa qenë i formalizuar (në asnjë lloj mënyre), të pretenduar si kur janë nxierrë të ardhura. Kjo është në përputhje edhe me parashikimin e nenit 24/2 të ligjit në fjalë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, nga prokurori u paraqiten prova se pasuria, objekti i ndërtuar mbi pasurinë me numër xxxx Zona Kadastrale xxxx Vol.xx, fq.xxx, është në zotërim të drejtpërdrejtë nga O. D. (ndonëse jo plotësisht por që do të argumentohet më poshtë). O. D. dhe palët e treta u munduan të paraqisnin prova se kjo pasuri është e ligjshme dhe është në zotërim (në bashkëpronësi) të të gjithëve (palëve në gjykim sipas investimit të tyre) dhe nuk zotërohet vetëm nga O. D..

Ajo për të cilën gjykata do të argumentojë më poshtë është prejardhja e kësaj pasurie dhe zotërimi i pasurive që nuk **i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave.**

Vlen të theksohet se pavërsisht se objekti është ndërtuar pas përfshirjes në veprimtarinë kriminale të O. D., para se të përfshihej ai në këtë veprimtari ka patur të ardhura të cilat në përqindje bëjnë që automatikisht për këtë pjesë (e investuar në objekt) të mospërfshihet në konfiskim (pra pjesa e të ardhurave të realizuara para përfshirjes në këtë veprimtari kriminale do ti zbritet në përqindje vlerës totale të objektit), gjë që prokurori nuk e ka patur parasysht në kërkimin e tij.

Gjykata do të ketë në fokusin e saj investimin e bërë nga O. D. (dhe familjarëve të tij, bashkëshortja dhe fëmijët) gjatë periudhës xxxx-xxxx, (diferencën e të ardhurave me shpenzimet).

Pavarësisht pretendimit të palëve, gjatë hetimit gjyqësor rezultoi e provuar se pasuria me numër xxxx Zona Kadstrale xxxx Vol.xx, fq.xxxx, me sipërfaqe xxxx m², ka ardhur si rezultat i pjestimit vullnetar të pasurisë me numër xxxx, në bashkëpronësi të shtetasve O. D., H. D., B. D., në zonën kadastrale xxxx vol.xx, faqe xxx, i pasurisë më sipërfaqe xxxx m² (pra është pjestuar në tre pjesë të

barabarta sipas aktit noterjal për pjestim vullnetar Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx).

Kjo pasuri duke qenë se është e vënë gjatë kohës që ai është në martesë, pavarësisht se është e rregjistruar në emër të O. D., përshkak të prezumimit ligjor (parashikim i K.Familjes, kur nuk kanë regjime pasurore të ndara) ajo është në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij Sh. D..

Personat e tretë H. D., N. D. dhe A. D., nuk paraqitën asnjë provë për të vërtetuar se sipërfaqja e pronës në fjalë të ishte në bashkëpronësi me ta, pra duke preluar në rastin konkret prezumimi ligjor se prona në fjalë është në pronësi(bashkëpronësi) të O. D. (me Sh. D. bashkëshortja e tij).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me objektin e ndërtuar mbi këtë pasuri (ndërtesa objekt konfiskimi), është ndërtuar vetëm me kontributin e O. D. dhe Sh. D. dhe jo të personave të tjetër të tretë.

Kjo pasi ndërtesa ka filluar të ndërtohet pa patur një datë të caktuar në vitin xxxx (por prezumimi ligjor është pas datës xxxx, datë në të cilën me vendimin Nr.x, datë xxxx, është miratuar leja e ndërtimit, themi prezumim ligjor pasi ndërtesa fillon të ndërtohet pas marrjes së lejes si rregull de iure), dhe ka përfunduar (në atë gjendje që ka qenë në momentin e sekuestrimit) në një datë të pa caktuar në Nëntor xxxx, (por para datës xxxx, kur me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, është bërë sekuestro preventive nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, dhe është mbajtur procesverbali përkatës për ekzekutim, kqyrje etj, për më tepër shiko aktet në dosje).

Pra ky objekti me sipërfaqe ndërtimore (sipërfaqja totale ndërtimore nga matjet në terren nga ekspertja vlerësuese e caktuar nga Gjykata është xxxx m², rreth xxxx m², më shumë se leja e ndërtimit e dhënë de iure) e ndërtuar mbi pasurinë me numër xxxx, zona kadastrale Nr.xxxx, vol.xxx, faqe xxx, duhet të jetë ndërtuar në periudhën kohore (cituat sa më lartë) ndërmjet xxxx-xxxx.

Të gjitha provat e paraqitura nga pesonat e tretë (ndër to Akt-Marrëveshja, datë xxxx, apo prokurë për të kryer veprime etj, mbajnë datën pas përfundimit të periudhës së ndërtimit të objektit, pas fillimit të proceseve penale ndaj O. D., pas sekuestrimit preventive të vendosur nga gjykata).

Pra provat e paraqitura nga palët e treta se “gjoja”, kanë marrë pjesë në ndërtimin e objektit përkatës për të cilin prokuroria kërkon ta konfiskoje janë fiktive dhe si të tilla konstatohen nga gjykata.

Në zbatim të nenit 3 paragrafi 6 të Ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar,

jo vetëm pasuritë e vëna pasi ky ligj ka hyrë në fuqi i nënshtrohen hetimit pasuror, por edhe pasuritë të cilat janë vënë para se ligji të ketë hyrë në fuqi, por me kusht që këto pasuri të jenë vënë gjatë kohës që personi dyshohet të jetë përfshirë në veprimtarinë kriminale, në një nga veprat penale të listuara në nenin 3/1 në një nga pikat e këtij paragrafi.

Në rastin konkret në gjykim rezultoi se përfshirja në veprimtarinë kriminale përket me në periudhën xxxx (kur ka filluar me veprën penale bazë që është fallsifikimi i TVSH deri kur ka vijuar me pastrimin e produkteve të veprës penale), të ardhurat janë vënë në këtë periudhë, por që realisht është formalizuar në vitin xxxx (pa përjashtuar të ardhurat e ligjshme për të cilat do të argumentohet më poshtë në vendim), çka në këtë rast e gjithë pasuria i nënshtrohet hetimit pasuror në zbatim të këtij ligji (me përjashtim të të ardhurave që ka patur O. D. dhe bashkëshortja e tij me datë xxxx, në shumën prej xxxx lekë, që përbën xxx % të investimit, e cila përjashtohet nga konfiskimi siç u argumentua sa më sipër).

Duke qenë se u provua sa më sipër, bazuar në nenin 21/3 e ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit/personave, kundër pasurive të të cilit/cilëve kërkohet konfiskimi.

Përsa i përket barrës së provës se pasuria është vënë në mënyrë të ligjshme, personi ndaj të cilit është kërkuar konfiskimi O. D. dhe bashkëshortja e tij Sh. D. (me cilësinë e personit të tretë në këtë gjykim) arriti të provojë se pjesërisht ka realizuar të ardhura të ligjshme (në kuptimi të nenit 24/2 të ligjit, nuk janë të ardhura të ligjshme të ardhurat dhe riinvestimet kur nuk janë paguar taksa dhe tatime, me interpretim akontrario janë të ardhurat të ligjshme kur janë paguar tatimet dhe taksat) si të ardhurat nga pagat e tyre, depozita bankare interesa etj (cituar shprehimisht tek akti i ekspertimit kontabël, dhe shtesat e këtij akti) ku për këtë pjesë gjykata nuk do të urdhërojë konfiskimin.

Pasi janë llogaritur shpenzimet për konsum familjarë (gjatë gjykimit nuk rezultoi që kjo familje të ketë patur shpenzime të tjera) diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimit familjar (për konsum), rezulton të jetë në shumën prej **xxxx lekë**. Pra këtë shumë kjo familje ka patur të gjitha mundësitë për të investuar në objektin ndërtimor për të cilin është kërkuar konfiskimi (pa lënë këtu në harresë shumën e parave që ai kishte në dispozicion me datë xxxx).

Ekspertët paraqitën dy variante të investimit (të cilat në vetvete janë me dhe pa TVSH), ku varianti i parë lidhet me faktin që nuk janë paguar sigurime shoqërore dhe Tatim fitimi (me dhe pa TVSH), dhe varianti i dytë me vlerat e situacioneve të punimeve të zbërthyera nga ekspertja sipas analizës së çmimeve të përcaktuara në manualin e vitit xxxx, pra vlera më e

përafërt e tregut në kohën e ndërtimit.

Nisur nga tërësia e provave në këtë gjykim, rezultoi e provuar se subjekti juridik xxxx Sh.p.k, nuk e ka ndërtuar objektin (me fuqinë punëtore të saj dhe sipas kushteve të marrëveshjes ku me anë të së cilës është marrë edhe leja e ndërtimit), aktmarëveshja, preventivi apo aktet e tjera vetëm sa janë shfrytëzuar për të marrë lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk rezulton që këtë objekt ta ketë ndërtuar ndonjë subjekt tjetër juridik.

Në kushte të tilla, referuar varianteve të paraqitura nga ekspertja, më i përshtatshëm për të nxjerrë vlerën e tregut në kohën e ndërtimit është varinti i dytë, ku ekspertja pasi ka zbërthyer punimet që janë bërë në objekt, i është referuar edhe çmimit të manualeve të ndërtimit të vitit xxxx, dhe se për këtë rast janë marrë parasysh edhe çmimet e tregut në kohën e ndërtimit. Po kështu duke qenë se objektin ndërtimor (godinat) nuk është ndërtuar nga subjekt juridik, O. D. nuk paraqiti ndonjë faturë tatimore (që të vërtetojë rimbursimin e saj), dhe duke u furnizuar se subjekt fizik, bazuar në legjislacionin mbi TVSh, ai që e mbart TVSH është blerësi i fundit i mallit që në rastin konkret është O. D..

Në këto kushte, gjykata çmon se duhet marrë parasysh varianti i dytë sipas aktit të ekspertimit lidhur me investimin me TVSH.

Gjatë gjykimit në asnjë moment (nuk u paraqit asnjë faturë e rregullt tatimore me përjashtim të disa faturave të thjeshta flet-dalje, kopja e dytë që nuk kanë ekstremitetet e një fature TVSH sipas miratimit nga Ministria e Financave), megjithëse nuk u provua që të jetë paguar TVSH në ndërtimin e godinave, por duke qenë se O. D., ka qenë blerësi i fundit i materjaleve ndërtimore, objekti nuk është ndërtuar nga ndonjë subjekt juridik, ai është mbartësi i fundit i TVSH. Sipas ekspertes vlerësuese duke u nisur nga fakti që nuk kishim fatura të rregullta TVSH (që përbën x% të vlerës së shtuar), këtë TVSH shteti e merr kur objekti të rregjistrohet.

Kjo realizohet në momentin që subjekti kërkon të rregjistrojë godinat, por gjatë gjykimit nuk rezultoj të jenë rregjistruar godinat objekt konfiskimi. Ekspertja vlerësuese u shpreh se në dosje nuk kishte prova që kjo taksë nuk ishte paguar, gjithashtu as O. D. (apo palët e treta, pasi kishin ata barrën e provës), nuk paraqitën prova se kjo taksë nuk është paguar.

Nga sa më sipër, gjykata çmon se për bazë duhet marrë varianti i dytë (çmimet më afër tregut në kohën e ndërtimit të godinave), me TVSH të paguar, që është **xxxx lekë** e cila në përpjestim me të ardhurat neto të familjes O. D. përbën **xxxx %** të investimit.

Në rrjedhje logjike (në interpretim ligjor) **xxxx %** të investimit, është realizuar me të ardhura të ligjshme të O. dhe Sh. D.. Duke patur parasysh se O. dhe Sh. D. me datë xxxx, kanë patur në dispozicion shumën prej **xxxx lekë** (e përjashtuar nga hetimi pasuror) **që përbën xxx %** të investimit (varianti i

dytë me TVSH), e mbledhur kjo me pasurinë e ligjshme të tyre për periudhën xxxx, (diferenca të ardhura-shpenzime konsumi në shumën prej **xxxx lekë**) që është **xxxx %** të investimit, e barabartë me **xxx %** e investimit. **Pra xxxx%** e investimit të godinave objekt konfiskimi janë të ligjshme dhe në këto kushte nuk mund të konfiskohen.

Pjesa prej **xxxx %** e investimit nuk është e justifikuar me burime të ligjshme.

Gjykata çmon se organi i akuzës gjatë gjykimit, ka paraqitur prova se pasuria objekt konfiskimi nuk është vënë në mënyrë të ligjshme pjesërisht (sipas përqindjes së përmendur më lartë), ndërsa personi ndaj të cilit kërkohet konfiskimi i pasurisë, nuk paraqiti prova për të vërtetuar se e gjitha pasuria është e ligjshme (por vetëm pjesërisht), ose provat me të cilat kërkoi të provonte një pretendim të tillë, nuk kanë vlerën e të provuarit të fakteve të pretenduara.

Nisur nga tërësia e provave shkresore me fuqi të plotë provuese, dhe të transkriptuara në aktet zyrtare (të pasqyruar edhe në aktet e ekspertimit), provohet se: Pasuria objekt konfiskimi e sipërfaqes ndërtimore prej **xxxx m²** në objektin e ndërtuar, e indentifikuar me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr.xxx, datë xxxx të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx, dhe matjes në terren nga ekspertja vlerësuese e pasurive të paluajtshme L. B., ndodhur mbi pasurinë e rregjistruar në Z.V.Rr.P.P xxxx nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xx, faqe xxxx, ndodhur në xxxx, do ti nënshtrohet konfiskimit, ku **xxxx %** i përket në pronësi O. D. së bashku me Sh. D., dhe **xxxx %** do të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.

Pas shqyrtimit të një sërë provash të cituara edhe më sipër, ku organi i akuzës i është drejtuar të gjitha institucioneve të cilat mund të kenë të dhëna për pasuritë e të paditurit apo familjarëve të tij, nuk rezulton që ai apo familjarë të tij gjatë kësaj periudhe të kenë ushtruar ndonjë aktivitet të ligjshëm ekonomik apo atë bujqësor sipas rregullave të parashikuara ligjore dhe të kenë nxjerrë të ardhura të ligjshme për ti vënë në shërbim të ndërtimit të objektit të konfiskimit.

Si nga pala ndaj të cilës është kërkuar konfiskimi i pasurisë, ashtu edhe nga palët e treta u paraqitën me cilësinë e provave disa deklarata (të thjeshta të nënshkruara nga vetë palët apo edhe noterjale) ku tregon mbi borxhet apo marrjet e huave si të O. D. ashtu edhe të personave të tretë.

Gjykata çmon se në referim të nenit 22 pika 5 të ligjit 10192/2009 i ndryshuar, dhe Vendimin Civil Unifikues Nr.x, të xxxx, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, aktet noterjale të më poshtme (si veprime juridike për marrjen përsipër të detyrimeve të paqena, kryeja e veprimeve si gjoja pjesmarrje në investim, huatë etj), janë absolutisht të pavlefshme dhe

si të tilla konstatohen kryesisht nga Gjykata edhe në këtë lloj gjykimi pavarësisht se nuk u kërkua nga asnjë prej palëve.

Vlen të theksohet se Procedimi Penal, nr.xxxx viti xxxx, që bën fjalë për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale, parashikuar nga neni 2871, gërma (d) i K.Penal, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, është rregjistruar që me datë xxxx, dhe të gjitha deklarata Noterjale, aktmarrëveshje, prokurë për kryerjen e punimeve, deklarata debitore ndaj të tretëve etj, janë bërë pas kësaj date, pra pas vënies në dijeni se ndaj tij po kryheshin hetime, madje pothuajse të gjitha janë bërë në vitin xxxx e në vijim, ndërkohë që pasuria objekt konfiskimi është vënë në sekuestro preventive që me datë xxxx.

Ndërsa disa deklarata të thjeshta me shkrim (të pa konfirmuara nga subjekte shtetërore, pa patur të bashkangjitur ndonjë faturë, kalim bankar etj) kanë të shënuar edhe data të mëparshme por vlera e tyre provuese është shumë e dyshimtë, dhe nuk lidhen me asnjë fakt apo provë që ato vërtetë i përkasin asaj periudhe, ku gjendet i drejtë pretendimi i Prokurorit se duke qenë shkresa private do të përbënte provë në favor të përpiluesit vetëm në qoftë se atë e paraqet si prova pala kundërshtare.

Duke i marrë me radhë këto akte konkludohet se:

Lidhur me aktin noterjal Kontratë “Akt-Marrëveshja” Nr.xxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, ku nënshkruesit janë **H. D., A. D., O. D., dhe N. D.** ku theksohet se: *...palët kanë rënë dakort për të drejtat e detyrimet në lidhje me ndërtimin e një kabanoni x kat dhe zyra për administratën x kat në tokën e trashëguar nga të parët në pronësi të tyre...që kanë rënë dakort që të drejtën e pronësisë ta ndajnë me nga xxx m² secili... duke përcaktuar përqindjen e aseteve në ndërtim ku O. D. ka xx %..”* fiktiviteti i saj qëndron në kohën e kryerjes së veprimit dhe në përmbajtjen e saj.

Lidhur me kohën e kryerjes së veprimit, O. D. (ndoshta edhe më parë por) të paktën që me datë xxxx, kur është vendosur sekuestro preventive me vendim Gjykate, vendim i cili rezulton edhe i transkriptuar edhe në ZRPP (për procedimin penal xxxx), ka ardhur në dijeni se për pasuritë e tij dhe të familjarëve, po kryheshin hetime në bazë të nenit 287 të K.Penal, dhe që pas kësaj date ka hartuar kontratën sa më sipër.

Fiktiviteti i një veprimi të tillë juridik, qëndron edhe në përmbajtje të saj. Personat sa më sipër edhe pse ishin në dijeni se pasuria nr.xxxx, zona kadastrale xxxx, ishte vetëm në emër të O. D., edhe pse leja e ndërtimit kishte dalur vetëm për llogari të tij, ata mundohen se kundrejt veprimeve fiktive dhe të simuluar, të kamuflojnë përkatësinë e vërtetë të kësaj pasurie. Nuk mund të ketë kontratë për ndarje të pasurisë nëse ajo nuk është në bashkëpronësi. Gjithashtu pjesmarrja në ndërtim

është fiktive pasi po ti referohesh akt-marrëveshjes ndërmjet xxxx Sh.p.k dhe O. D., investitori do të ishte vetëm ky i fundit (pavarësisht se si rrodhën më pas veprimet). Palët ose mund të kishin bërë shitje, dhurim, shkëmbim, por jo të lidhnin një ‘marrëveshje’ për ndarjen e një sendi që realisht i përkiste një personi që është O. D. (pavarësisht se ky e ka në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij Sh. D.).

Kontrata noterjale cituar sa më lartë, ku merren përsipër të drejta dhe detyrime, të paqena :veprime juridike të bërë me marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike, duke kryer kështu një veprim juridik nul, fiktiv, të paqenë, ku në bazë të 22, pika 5 (dhe nenit 92/ç të K.Civil), janë absolutisht ta pavlefshme të cilat Gjykata i konstaton edhe kryesisht pa patur kërkesë të palëve.

I njëjti argument është edhe për Prokurën Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, ku autorizohet O. D., nga H., A. dhe N. D., që të përgatisë dokumentacion për ndërtimin e kabanonit, të nxirrë lejen e sheshit të ndërtimit, nxirrjen e lejes së ndërtimit etj, këto veprime ti kryejë edhe në emër dhe për llogari të tyre, ndërkohë që leja e ndërtimit ishte nxirrë tashmë që në xxxx, dhe ndërtesa kishte përfunduar që me datë xxxx etj.

Kjo prokurë edhe një herë provon fiktivitetin e veprimeve që po mundoheshin të kryenin personat e tretë si “gjoja”, investitor të objektit që i ishte nënshtruar sekuestrimit preventiv tashmë.

I njëjti argument është edhe përsa i përket aktit shkresor (shkresë e thjeshtë private) të titulluar Detyrimet Debitore ndaj të tretëve, që mban datën xxxx, ku O. D., H., A. dhe N. D. kanë thesuar se kanë borxhe ndaj të tretëve lidhur me “punimet “ e realizuar nga të tretët. Një shkresë e tillë e thjeshtë e pa mbështetur në asnjë provë tjetër, ndërkohë që provohet fiktiviteti dhe fakti që H., A. dhe N. D., se nuk kanë marrë pjesë në këtë investim, nuk ka asnjë vlerë provuese për më tepër që tregon edhe një herë fiktivitetin e këtyre veprimeve.

I njëjti argument është edhe përsa i përket aktit shkresor (shkresë e thjeshtë private) të titulluar Deklaratë huadhënie e nënshkruar nga D. Q. dhe O. D. dhe H. D., ku sipas së cilës huamarrësit i kanë marrë hua shumë prej xxxx lekë, që mban datë xxxx, me afat x vjeçar. Asnjë provë apo fakt që të vërtetojë kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate nuk u paraqit nga palët në këtë gjykim. Vlera e saj provuese nuk ngrihet në nivelin e provës që kërkohet të vërtetojë faktin juridik të pretenduar dhe në kushte të tilla gjykata nuk e merr parasysh.

I njëjti argument është edhe për Deklaratë huadhënie (shkresë e thjeshtë), që mban datën xxxx, të nënshkruar nga M. B. dhe

H. D. dhe O. D., për huamarrjen e një shume prej xxxx (xxxx) lekë. Shkresat e mësipërme nuk shoqërohen me asnjë akt tjetër, faturë akt të kalimit të vërtetë të këtyre parave, ato nuk kanë të shoqëruara gjeneralitetet e plota të palëve, madje i kanë me gabime (në vend të H. e shënojnë vazhdimisht H.), nuk kishin të bashkangjitur as letërnjoftimet dhe vetëm kur jua kërkoj gjykata ata paraqiten fotokopje të letërnjoftimit) (Po kështu edhe për shkresat e tjera të thjeshta të cilat nuk po i përmendim me rradhë).

Nga argumentimi sa më sipër, ku Gjykata theksoi se palët e treta H., N. dhe A. D., nuk kanë marrë pjesë në investimin e godinave objekt konfiskimi (veprimet e tyre rezultuan fiktive), nuk çmon të verifikojnë më tej vlerën juridike të veprimeve të realizuara ndërmjet tyre dhe personave të tjerë (kontrata noterjale apo akte të thjeshta, lidhur me borxhet apo mundësitë e tyre ekonomike), pasi e çmon të panevojshëm në këtë rast.

Përsa i përket kontratave të lidhura nga palët e treta njëri me tjetrin apo me persona të tjerë, duke qenë se nuk passjellin pasoja në këtë gjykim gjykata nuk shprehet për to, pasi dalin tej objektit të këtij gjykimi.

Gjykata çmon se edhe pse Kodi Civil, nuk kërkon ndonjë formë të veçantë për kontratën e Huasë, përsëri ato për të garantuar shlyerjen e tyre, dhe për tju përmbajtur kushteve duhet që në kohën e arritjes së marrëveshjeve, ato të formalizoheshin. Aq më tepër kur bëhet fjalë për shuma të konsiderueshme sa më sipër, për interesa dhe për afate shlyerjeje.

Një tjetër argument që e bind gjykatën në fiktivitetin e këtyre veprimeve juridike, është se palët nuk paraqiten qoftë edhe një faturë bankare apo të thjeshtë të kohës që tregonte për kalimet e këtyre shumave nga njëra palë tek tjetra, apo shlyerjes së kësteve apo interesave.

Lidhur me deklaratën Noterjale Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, lëshuar nga A. M. dhe D. K., ku sipas të cilave kanë deklaruar se për shitjen e pronës nr.xxxx, me sipërfaqe xxxx m², të cilën e ka blerë O. D., nuk kanë marrë para por ja kanë dhënë për “respekt” ish pronarit të vjetër H. D., kjo nuk mund të ketë vlerë provuese mbi kontratat e shitblerjes apo të tjetërsimit të pasurisë. Aq më tepër një deklaratë e lidhur rreth x vite pas shitjes së pronës në kohën kur ndaj O. D., kishte filluar procedimi pasuror ndaj tij.

Pra tërësia e veprimeve si në formë ashtu edhe në përmbajtje tregojnë për një fiktivitet të veprimeve juridike të tilla, dhe qëllimi i vërtetë i tyre ka qenë “legalizimi, formalizimi” i shumave të konsiderueshme, për të kamufluar prejardhjen e parave nga aktiviteti kriminal i personave subjekte të nenit 3 të Ligjit 10192/2009 i ndryshuar, dhe si të tilla ato janë nul duke u konsideruar si absolutisht të pavlefshme. Ndër të tjera në vendimin

Unifikues Nr.5/2012 theksohet se: *Veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj.*

Për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës....“.

Gjykata çmon se edhe pse palët nuk kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike sa më lartë, ata janë veprime juridike nul, të paqena dhe si të tilla nuk mund të sjellin pasoja juridike, duke u konstatuar si të tilla.

Gjykata çmon se plotësohet edhe kushti i parashikuar nga neni 24/1/c, ku për 75.18% të vlerës së investimit nuk u provua që pasuria të kishte prejardhje të ligjshme, dhe ky investim është shpërpjestimor me nivelin e të ardhurave (vetëm pagat e O. dhe Sh. D.).

V.Lidhur me pretendimet e palëve.

Gjykata çmon se Prokuroria ka gabuar në momentin që kërkon të bëjë pjesë të konfiskimit dhe të mos merren parasysh të ardhurat që kishte O. dhe Sh. D. me datë xxxx, duke passjellë edhe përqindjen në kërkimin për konfiskim.

Pavarësisht se palët në Gjykim i referohen lejes së ndërtimit (pra metrave katrorë që janë dhënë me këtë leje), gjykata çmon se duhet bërë referimi jo vetëm tek leja e ndërtimit por edhe tek matjet në terren që ka bërë ekspertja vlerësuese për sipërfaqen ndërtimore të objektit.

Në nenin 12 pika 4 e ligjit parashikohet ndër të tjera se kërkesa e prokurorit për revokimin e sequestrimit nuk pengon Gjykatën të vendosë konfiskimin e pasurisë kur ajo çmon se plotësohen kriteret e parashikuara në këtë ligj. Është jo logjike dhe as juridike të kërkohen konfiskimi i objektit të ndërtuar me leje, ndërkohë që pjesa e ndërtuar tej lejes të mos kërkohet apo të mos i referohen palët në kërkime. Prandaj Gjykata ka marrë si bazë llogaritje xxxx m² sipërfaqe ndërtimore, aq sa ka nxierrë ekspertja pas matjeve në terren.

Përsa i përket pretendimit për legjitimitimin aktiv dhe pasiv, Gjykata çmon se këtij pretendimi i ka dhënë përgjigje i gjithë vendimi i arsyetuar në tërësinë e tij. Pala (O. D.) pretendon se duke qenë se sendi nuk është i lirë në qarkullimin civil, nuk mund të tjetërsohet dhe nuk mund të kërkohet konfiskimi. Ligjvësi me ligjin Nr.10192/2009, i ndryshuar, që në nenin 1 ka përcaktuar objektin e këtij ligji, në nenin 2 qëllimin e tij, dhe në nenin 3 e vijues, subjektet ndaj të cilëve zbatohet si dhe organet shtetërore të ngarkuara me hetimin, paraqitjen e kërkesave, hapat që ndiqen deri në konfiskimin e këtyre pasurive. ■

Pavarësisht se çfarë terminologjie përdor ligji, ajo që është e rëndësishme është se Prokuroria është organi shtetëror që i drejtohet Gjykatës me kërkesën për konfiskimin e pasurisë, ku Prokuroria është pala kërkuese, personi që zotëron pasuritë (direkt ose indirekt) është ai ndaj të cilit drejtohet hetimi dhe gjykimi me objekt konfiskimin e pasurisë, është përcaktuar që Gjykata është mbi palët.

Vetë Ligji dhe praktika Unifikuese, e kanë përcaktuar këtë lloj procedimi (miks) siu generis, dhe sipas nenit 22/1 të ligjit, gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pra primare janë dispozitat e këtij ligji, dhe për aq sa është e mundur dispozitat e ligjeve të tjera.

Lidhur me pretendimin se duke qenë se objekti është ndërtuar jo duke respektuar kondicionet ligjore, nuk është i rregjistruar dhe nuk mund të jetë objekt pjestimi (duke referuar edhe në Vendimin Unifikues Nr.xx/xxxx), gjykata çmon se ky pretendim është i pabazuar në ligj, dhe as nuk gjen vend zbatimi i vendimit unifikues në këtë rast.

Kjo pasi dispozitat si procedurjale penale, dispozitat penale ashtu edhe ligjit 10192/2009, i referohen konfiskimit si të pasurive të luajtshme ashtu edhe pasuritë e paluajtshme që janë produkt i veprave penale apo i të ardhurave nga to. Dhe si e tillë çdo send që ka një vlerë dhe është produkt i veprës penale i nënshtrohet konfiskimit sipas ligjit sa më sipër.

Vendimi Unifikues zbatohet për sende kur nuk janë të rregjistruara, nuk janë respektuara kondicionet e lejes apo për shkelje administrative dhe jo për sende që janë produkt i veprës penale.

Pretendimi (i përbashkët i të gjitha palëve si O. D. ashtu edhe personave të tretë) se sendi objekt konfiskimi është ndërtuar me kontributin e të gjithëve dhe O. ka vepruar në emër dhe për llogari të tyre, u sqarua sa më sipër në vendim dhe ky pretendim merr përgjigje në tërësinë e vendimit.

Lidhur me pretendimin e zgjedhjes së varianteve të paraqitur nga ekspertët, me apo pa TVSH, merr përgjigje sa më sipër në vendim. Pretendimi se në Gjykatën xxxx, është një çështje civile e pezulluar ku palët e treta kanë kërkuar lirimin e sekuestros, nuk lidhet me vendimmarrjen e kësaj Gjykate, pasi sipas vendimit mbi pezullimin është pikërisht ajo çështje e ndërvarur nga çështja objekt gjykimi dhe jo e kundërta.

Pretendimi i Sh. D. për bashkëpronësinë, dhe për kontributin e saj i është dhënë përgjigje sa më lartë, ku kontributet e ligjshme si të saj, ashtu edhe të O. D., janë llogaritur nga Gjykata. Edhe pretendimet e personave të tretë për kontributin në këtë objekt kanë marrë përgjigje sa më lartë në vendim.

Barra e Provës sipas këtij ligji për të provuar lidhur me kontributin dhe ligjshmërinë e pasurisë ju takon personave ndaj të cilëve paraqitet

kërkesa për konfiskim. Në rastin konkret sipas ligjit të posaçëm, zbatohen dispozitat e ligjeve të tjera për aq sa është e mundur.

Por vetë ligjvënësi sipas këtij ligji, ka ceduar në disa parime juridike civile dhe penale duke u nisur nga interesi publik, ku i ka kaluar barrën e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, dhe që i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi (neni 21/3 i ligjit 10192/2009). Kjo duke u bazuar edhe në aktet Ndërkombëtare siç është “KONVENTA MBI PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TE KRIMIT, Strasburg, 8.XI.1990, ratifikuar me Ligj nr.8646, datë 20.7.2000”, apo akte të tjera ndërkombëtare në fushën e Krimin të Organizuar. ■

VI. Shpenzimet procedurjale.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, ku eksperti kontabël është paguar në shumën prej xxxx (xxxx) lekë, ekspertja vlerësuese në shumën prej xxxx (xxxx) sipas faturave tatimore të shitjes bashkangjitur akteve të ekspertimit), shpenzimeve hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore sipas formularit bashkangjitur, parapaguar nga shteti, iu ngarkohen O. D. dhe Sh. D., në masën e xx % të tyre. Kjo në zbatim të nenit nenit 25 pika 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

VII. Ekzekutimi i vendimit dhe administrimi i pasurive objekt konfiskimi.

Gjykata çmon se është i bazuar edhe kërkimi i Prokurorisë përsa i përket institucioneve të ekzekutimit të vendimit dhe administrimit. Në këto kushte, për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria për Krime të Rënda dhe Policia Gjyqësore pranë saj dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori S. M. (sipas kërkesës së Prokurorit).

Përsa i përket të drejtës së ankimit kundër vendimit për konfiskimin e pasurisë, në nenin 27 pika 2, të ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, është parashikuar e drejta e ankimit sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedures Penale, dhe se ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Ankimi në Gjykatën e Apelit sipas K.Pr.Penale, parashikohet në nenin 415 pika 1 të tij, i cili është 15 ditë, dhe duke qenë se ligji nuk parashikon ndryshe, gjykata çmon se edhe në rastin konkret vlen ky rregull për ankimin.

Në nenin 28/1 parashikohet se vendimi i konfiskimit të pasurive vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar nënenet 3, 7/1/4, 21-28, të ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër

pasurisë” i ndryshuar, nenet 112, 390, 393/1 415, 485, të K.Pr.Penale,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.
2. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurisë së paluajtshme të një sipërfaqe ndërtimore prej **xxxx m²** në objektin e ndërtuar, identifikuar me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr.xxxx, datë xxxx të KRRT-së së Këshillit të Qarkut xxxx dhe matjeve në terren të ekspertes, ndodhur mbi pasurinë e rregjistruar në Z.V.Rr.P.P xxxx nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi xxx, faqe xxx, ndodhur në xxxx, që përbën masën prej xxxx % (xxxx) e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore.
3. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria për Krime të Rënda dhe Policia Gjyqësore pranë saj dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori pranë këtij institucioni, S. M..
4. Urdhërohet kryesekretaria pranë kësaj gjykate, që t'i komunikojë një kopje të këtij vendimi Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, si dhe Prokurorisë Pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.
5. Shpenzimet hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore (sipas formularit përkatës), përs hirë dhe shpenzimet për ekspertimet të kryera gjatë gjykimit në masën 120.000 lekë (njëqind e njëzet mijë) lekë, të parapaguara nga shteti, i,u ngarkohen O. D. dhe Sh. D., në masën e x % të tyre, pjesa tjetër i ngarkohet shtetit. **6.**Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ankim i cili nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 27.09.2018.

SEKRETARE

Alma STAJAJ

GJYQTAR

Bib NDRECA

